

VENDIM
Nr. 291, datë 24.4.2026

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIKUALIFIKIMI URBAN NË LAGJEN “5 SHTATORI”, ÇOROVODË, BLOKU NR.1 (FAZA E PARË)”, BASHKIA SKRAPAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikimi urban në lagjen “5 Shtatori”, Çorovodë, blloku nr.1 (faza e parë)”, Bashkia Skrapar.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Skrapar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “ndërtesë” dhe “garazh”, me një vlerë të përgjithshme prej 893 955 (tetëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 893 955 (tetëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë) lekësh përballohet nga buxheti i Bashkisë Skrapar.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Skrapar.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në “Fletoren zyrtare” dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Skrapar.

8. Bashkia Skrapar kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Skrapar.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Skrapar për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe të regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Skrapar për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Skrapar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË PRONË PRIVATE, E TË CILËVE SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIKUALIFIKIM URBAN NË LAGJEN 5 SHTATORI ÇOROVODË, BLOKU NR 1 (FAZA E PARË)”

Nr. rendor	Pronari			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)												Vlera Totale (lekë)	Shënime
													Ndërtesë				
	Emër	Atësia	Mbie mër	Qyteti	Z.Kadastrale	Nr. i Pasurisë	Lloji i Pasurisë	Sip. Totale (m²)	Truall (m²)	Ndërtese(m²)	V ol	Fa qe	Sipërf aqja (m²)	Çmimi (Lekë/ m²)	Vlera (lekë)		
1	Ylli Dhurata	Shuaip Avni	Shahin i Shahin i	Çorov odë	1420	13/100	Garazh	22	0	22	16	151	22		322,803	322,803	
2	Nasip	Skënder	Kono	Çorov odë	1420	13/86	Ndërtesë	30	0	30	11	138	30		571,152	571,152	
Vlera Totale																893,955	